

**UDHËZIM**  
**Nr. 43, datë 21.8.2013**

**PËR PLANIFIKIMIN E FONDEVE BUXHETORE, PROKURIMIN DHE BLERJEN E MJETEVE MËSIMORE PËR INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të shkronjës “ç”, pikës 2 të nenit 30 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”,

**UDHËZOJ:**

1. MASH-i, brenda fondeve të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit, dërgon te çdo drejtori arsimore rajonale (DAR)/zyrë arsimore (ZA);

a) fondin e planifikuar për blerje të mjeteve mësimore, sipas formulës “Për nxënës të regjistruar në fillim të vitit shkollor”;

b) listën e mjeteve mësimore, bashkë me çmimet mesatare të kontratave të mëparshme ose të referencës.

2. DAR/ZA-ja përllëgarit për çdo institucion arsimor publik, sipas formulës “Për nxënës të regjistruar në fillim të vitit shkollor”, fondin e planifikuar për blerje të mjeteve mësimore dhe njofton zyrtarisht çdo institucion arsimor publik për fondin që i takon.

3. Drejtori i institucionit arsimor publik dërgon në DAR/ZA kërkesën e institucionit për mjetet mësimore bazuar në:

a) fondin vjetor të institucionit për mjete mësimore;

b) listën e mjeteve mësimore dhe çmimet mesatare;

c) propozimet e mësuesve.

4. DAR/ZA-ja, bazuar në kërkesat e dërguara nga institucionet arsimore publike, dërgon në MASH, listën përmbledhëse të mjeteve mësimore të kërkuara në nivel DAR/ZA-je.

5. MASH-i realizon procedurat e prokurimit publik dhe njofton çdo DAR/ZA për listën e mjeteve mësimore përfituese.

6. Bazuar në kërkesat e kontratës, një komision verifikon në magazinën e blerësit sasinë, cilësinë, llojin, qenien e plotë dhe markën e prodhimit, si dhe çdo specifikim teknik që është pjesë e kontratës.

Komisioni krijohet me urdhër të titullarit të DAR/ZA-së dhe përbëhet nga jo më pak se tre veta: magazinieri i DAR/ZA-së dhe specialistë, sipas llojit të vlerave materiale.

Komisioni mban procesverbal për mjetet mësimore, që verifikohen me të meta të fshehta ose nuk përmbushin specifikimet teknike.

7. Titullari i DAR/ZA-së njofton shoqërinë fituese për konstatimet e komisionit, sipas afateve dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

8. Çdo institucion arsimor publik, që, gjatë përdorimit të mjeteve mësimore, konstaton të meta të fshehta ose që nuk përmbushin specifikimet teknike, njofton zyrtarisht DAR/ZA-në.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Planifikimit Buxhetor dhe DAR/ZA-të.

Ky udhëzim hyn në fuqi pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Myqerem Tafaj**